

FJALA E DEPUTETES HATIXHE KONOMI

E ENJTE 21 PRILL 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Pa dyshim, askush prej nesh nuk e kishte menduar që në vitin 2022 do të përjetonim një situatë lufte në gjirin e Europës dhe një sërë problematikash social-ekonomike si pasojë e saj. Jemi të trishtuar sa më s'ka për këtë fakt, por me sytë çelur në angazhimin maksimal për t'iu përgjigjur siç duhet kësaj sfide të madhe që po kalon e gjithë bota mbarë, rrjedhimisht edhe vendi ynë. Përtej angazhimeve, misionëve në rang kombëtar dhe qasjeve tona, krahas të drejtës, të duhurës, progresit e, mbi të gjitha, njerëzores, jemi maksimalisht të mobilizuar për të menaxhuar edhe pasojat lokale ekonomike, më konkretisht ato që tani kanë prekur shtëpitë e shqiptarëve.

Rritja e çmimeve në mënyrë të pakontrollueshme, ndër të tjera, si pasojë e tronditjes së tregjeve ndërkombëtare është sfida e radhës që duhet ta përballojmë me sukses. Ne kemi treguar se nuk u shmangemi krizave, por jemi aty bashkë e krahu qytetarëve. Ashtu siç ishim pas tërmetit të tmerrshëm të 26 nëntorit apo gjatë pandemisë së zgjatur, ashtu do të jemi edhe tani. Mbrojtja e konsumatorit duhet të jetë pa dyshim prioriteti i çdo qeverie e për ne qytetarët janë pa diskutim A-ja e çdo vendimi të marrë. Për fat të mirë, sot kjo nuk është më një klishe. Paketa e rezistencës sociale, me të cilën tashmë jemi njohur të gjithë, është një nga masat e marra në mënyrë të menjëhershme nga qeveria për menaxhimin krizës dhe mbështetjen e qytetarëve.

Tashmë Këshilli i Ministrave vjen me një propozim, atë të aktit normativ "Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg". Me anë të këtij akti normativ synohet përcaktimi i masave të veçanta që do të merren ndaj subjekteve publike ose private, vendase apo të huaja, të cilat kanë si objekt të veprimtarisë së tyre importimin dhe prodhimin e produkteve ushqimore bazë gjatë gjithë kohëzgjatjes së situatës së veçantë në tregun shqiptar, i ndikuar nga situatat në tregun ndërkombëtar. Me pak fjalë, qeveria, nëpërmjet këtij akti, do të monitorojë për një kohë të caktuar çmimet e produkteve të shportës të rritura së fundi për shkak të agresionit rus në Ukrainë, të problematikave të tregjeve ndërkombëtare, të vështirësive për t'u furnizuar në tregjet e jashtme apo edhe të spekulimet e çmimeve nga vetë tregtarët.

Ky monitorim do të ndjekë të gjithë ecurinë që nga furnizuesit, marketet, tregtarët e deri te konsumatori. Situata e kërkon domosdoshmërisht një akt të tillë normativ, i cili ka filluar më herët zbatimin e tij dhe vjen sot në parlament për të marrë fuqi ligjore. Askush nuk duhet dhe nuk do të mund të përfitojë në kurriz të qytetarëve të thjeshtë të këtij vendi dhe për këtë jam e bindur se jemi bashkë, maxhorancë e opozitë. Ndoshta situata na kapi pak në befasi, por unë besoj fort se sot ne kemi mbi

tryezë mekanizmat e duhur për t'i minimizuar sado pak risqet anësore. Sikurse edhe në aktin normativ numër 5, ku përcaktohet krijimi i bordit të transparencës dhe kufizimit të përkohshëm të çmimeve të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe gazit, edhe në këtë projektakt është përcaktuar ngritja e bordit të transparencës dhe monitorimit të çmimeve të tregtimit me shumicë/pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to, i cili ngrihet dhe funksionon vetëm në rastin e situatave të veçanta, në kuptim të këtij akti normativ.

Hartimi dhe miratimi i këtij akti normativ nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2022, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, por koha në të cilën jetojmë e bën atë të domosdoshëm. Akti normativ është hartuar në përputhje me Kushtetutën. Neni 101 i Kushtetutës ka parashikuar të drejtën e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullatore me fuqinë e ligjit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra. Nevoja dhe urgjenca janë elemente me rëndësi të veçantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe, si të tilla, janë elemente përcaktuese për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë.

Akti normativ përbëhet nga objekti dhe 12 nene, ku, ndër të tjera, përcaktohet objekti i këtij akti; kriteret që përcaktojnë situatën e veçantë; ngritja e bordit, roli, kompetencat dhe funksioni i tij; vlerat e produkteve bazë ushqimore dhe atyre të lidhura me to; masat e veçanta administrative, ku përcaktohet se, në rast të mosrespektimit të marzhit të fitimit të vendosur nga bordi për produktet ushqimore bazë dhe produktet e tjera të lidhura me to, do të zbatohen edhe sanksione. Produktet ushqimore, për të cilat zbatohet situata e veçantë dhe parashikimet sipas këtij akti normativ, përcaktohen me vendim të bordit. Situata e veçantë shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, dua të theksoj se ky akt normativ nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit.

Të nderuar kolegë,

Besoje se ka momente ku nuk vlen ndasia politike e ky është një ndër to. Ky akt normativ vjen qartazi si një veprim i qeverisë shqiptare në mbrojtje të konsumatorit, vjen si një përpjekje e formësuar në një situatë të pazakontë emergjence në mbështetje të qytetarëve për të lehtësuar dhe për të zbutur efektet e krizës botërore në përditshmërinë tonë. Prandaj, të nderuar kolegë, unë do t'ju ftoj ta mbështesni. Edhe pse votimi ka mbaruar, shpresoj ta keni mbështetur me votë këtë projektligj. Ju falënderoj për vëmendjen!